



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, më 21 maj 2012
Nr. ref.:RK239/12

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin Nr. KO123/10

Parashtruesi

Komuna e Gjakovës

**Vlerësimi i kushtetutshmërisë të aktgjykimit të Gjykatës Ekonomike të Qarkut në
Prishtinë Nr. C. nr. 183/2009 të 17 qershorit 2009**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Ivan Čukalović, gjyqtar
Gjyljeta Mushkolaj, gjyqtare dhe
Iliriana Islami, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Komuna e Gjakovës. Në procedurën pranë Gjykatës Kushtetuese, Komuna përfaqësohet nga z. Afrim Radoniqi, përfaqësues ligjor i Komunës së Gjakovës.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi konteston Aktgjykimin Nr. C. Nr. 183/2009 të Gjykatës Ekonomike të Qarkut në Prishtinë të datës 17 qershor 2009 që i është dorëzuar parashtruesit më 18 korrik 2009.

Objekti i çështjes

3. Objekti i çështjes së kësaj kërkesë ka të bëjë me padinë e ushtruar nga Instituti për Mbrojtjen e Monumenteve –Tiranë kundër Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit të komunës së Gjakovës për kompensimin e borxhit në shumën prej 16,206.00 Euro.

Baza juridike

4. Neni 113.4 dhe neni 113.7 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Kushtetuta), neni 20 dhe 49 i Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm : Ligji) dhe Rregulli 56 i Rregullores së Punës të Gjykatës Kushtetuese (në tekstin e mëtejshëm: Rregullorja e Punës).

Procedura në Gjykatë

5. Më 9 dhjetor 2010, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatë.
6. Më 27 janar 2011 Gjykata Kushtetuese njoftoi Gjykatën Ekonomike të Qarkut në Prishtinë, lidhur me dorëzimin e kërkesës së përmendur. Më 4 shkurt 2011, Gjykata Ekonomike e Qarkut në Prishtinë ia dorëzoi Gjykatës dosjen e lëndës së parashtruesit të kërkesës.
7. Më 13 maj 2011 pasi shqyrtoi raportin e Gjyqtarës Raportuese, Gjyljeta Mushkolaj, Kolegji Shqyrtues i përbërë nga gjyqtarët: Snezhana Botusharova (kryesuese), Enver Hasani dhe Kadri Kryeziu, i rekomandoi Gjykatës në përbërje të plotë për papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve dhe pretendimeve siç janë paraqitur nga parashtruesi i kërkesës

8. Instituti për Mbrojtjen e Monumenteve –Tiranë dorëzoi një ankesë kundër Drejtorisë së kulturës, Rinisë dhe Sportit të Komunës së Gjakovës, për kompensimin e borxhit në shumën prej 16,206.00 Euro.
9. Me Aktgjykimin Nr. C. nr. 183/2009, Gjykata Ekonomike e Qarkut në Prishtinë konstaton se Instituti për Mbrojtjen e Monumenteve-Tiranë dhe Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport e Komunës së Gjakovës kanë pasur marrëdhënie kontraktuese, sipas kontratave dhe atë: Kontratë mbi kryerjen e dokumentacionit tekniko-investues nr. 18, me të cilën paditësi është obliguar që për llogari të paditurës të hartojë projektin të konservimit të “Urës së Taliqit” në Gjakovë dhe Kontratën mbi kryerjen e dokumentacionit tekniko-investues nr. 19, me të cilën paditësi është obliguar që për llogari të paditurës ta kryejë hartimin e projektit të konservimit të “Urës së Tabakut” në Gjakovë. Paditësi i ka përmbushur obligimet e veta kontraktuese ndaj të paditurës, ndërsa e paditura nuk e ka përmbushur obligimin e lidhur

me pagesën e çmimit kontraktues, edhe pse Bordi i Drejtorëve të Komunës së Gjakovës me Vendimin e datës 10 maj 2004, ka vendosur që paditësit t'i bëhet pagesa për punët e kryera.

10. Gjykata Ekonomike e Qarkut përmes Aktvendimit II. C. nr. 183/2009, të datës 21 maj 2009, detyroi Drejtorinë për Kulturë, Rini dhe Sport të Komunës së Gjakovës që të paraqes përgjigje në padi dhe në bazë të dokumenteve të dorëzuara, nuk është dorëzuar asnjë përgjigje.
11. Të njëjtën ditë, më 21 maj 2009, Gjykata Ekonomike e Qarkut lëshoi një thirrje për paraqitje në seancë përgatitore që do të mbahej më 17 qershor 2009. Mirëpo, në aktgjykimin nr. C. nr. 183/2009 nuk përmendet nëse e paditura ishte e pranishme në seancë.
12. Kundër aktgjykimit Nr. C. nr. 183/2009, të datës 17 qershor 2009, e paditura ka paraqitur Ankesë me datën 6 gusht 2009, duke mos e përfillur afatin e përcaktuar ligjor për parashtrimin e ankesës. Gjykata Ekonomike e Qarkut në Prishtinë përmes Aktvendimit të datës 12 gusht 2009 e hodhi poshtë ankesën si të paafatshme.
13. Parashtruesi i kërkesës pretendon se Aktgjykimi i Gjykatës Ekonomike të Qarkut në Prishtinë, i datës 17 qershor 2009, nr. C .nr. 183/2009, përmban shkelje të rëndë të Ligjit mbi Menaxhimin e Financave Publike Nr. 03/L-0478, përkatësisht nenit 68 (1,2,3 dhe 4),
14. Rrjedhimisht, Komuna e Gjakovës pretendon se Gjykata Ekonomike e Qarkut në Prishtinë nuk ka zbatuar dispozitat e lartcekura të nenit 68 duke mos marrë parasysh kërkesën e Komunës, të datës 26 maj 2009, për pezullimin e çështjes në afat prej 180 ditësh.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

15. Në mënyrë që të jetë në gjendje të vendosë për kërkesën e parashtruesit, Gjykata duhet të vlerësojë paraprakisht nëse parashtruesi i ka përmbushur të gjitha kërkesat për pranueshmëri të kërkesës, të parapara me Kushtetutë, Ligj dhe Rregullore të Punës.
16. Përmbushja e të gjitha kushteve në mënyrë kumulative është qenësore për të parashtruar një çështje në Gjykatën Kushtetuese në mënyrë ligjore.
17. Dhe në lidhje me këtë Gjykata i referohet nenit 113.1 të Kushtetutës ku thuhet:
18. *“Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar”.*
19. Neni 113.4 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës përcakton si në vijim:
“Komuna është e autorizuar të kontestojë kushtetutshmërinë e ligjeve ose të akteve të Qeverisë, të cilat cenojnë përgjegjësitë komunale ose zvogëlojnë të hyrat e komunës, në rast se komuna përkatëse është prekur nga ai ligj ose akt”.
20. Gjykata vëren se çështja e parashtruar nga Komuna e Gjakovës nuk ka të bëjë me *“kontestimin e kushtetutshmërisë së ligjeve ose të akteve të Qeverisë”*, por ajo sfidon Aktgjykimin e një Gjykate të rregullt, dhe si e tillë është e papranueshme.
21. Gjykata gjithashtu vëren se në pajtim me nenin 21 të Kushtetutës:

22. “ Të drejtat dhe liritë themelore të parashikuara në Kushtetutë ,vlejnë edhe për personat juridikë për aq sa janë të zbatueshme”

Dhe neni 5 i Ligjit nr. 03/L-040 për vetëqeverisjen lokale, në nenin 5 përcakton se:

23. “Komuna është person juridik. Si person juridik, çdo komunë ka kompetenca, në mes tjerash, të padisë dhe të paditet në gjykata;

24. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113(7) të Kushtetutës i cili përcakton:

“Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”

25. Përkundër faktit se Komuna është e autorizuar që të ngrejë këtë rast në Gjykatën Kushtetuese, duhet të përmbushen kërkesat tjera për papranueshmëri të parapara me Kushtetutë, Ligj dhe Rregullore të Punës.

26. Në këtë drejtim Gjykata i referohet nenit 49 të Ligjit, që përcakton:

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor...”

27. Gjykata vëren se aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës Ekonomike të Qarkut është nxjerrë më 17 qershor 2009 dhe i është dorëzuar parashtruesit së kërkesës më 18 korrik 2009, ndërkaq parashtruesi ka dorëzuar kërkesën në Gjykatën Kushtetuese më 9 dhjetor 2010.

28. Prandaj, kërkesa është parashtruar jashtë afatit të përcaktuar me nenin 49 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.4 dhe 113.7 të Kushtetutës si dhe me nenin 49 të Ligjit, njëzëri

VENDOS

I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme.

II. Ky Vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;

III. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë .

Gjyqtarja Raportuese

Dr. Gjyljeta Mushkolaj

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese

Prof. Dr. Enver Hasani